

Z. KRYGTARIT



REPUBLIKA E KOSOVËS Komuna e Drenasit (Glllogocit)



Zyra e Kuvendit të Komunës
12 Nr. 031-13311 dt: 05.08.2013

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika 40.2 nën b dhe c të ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe nenit 17 të Ligjit nr.03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.27/2008), nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtimin, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2012 mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit – tarifatat për rregullimin e infrastrukturës, Pëlqimit nr.1642-2/13 të datës 20.05.2013 për zbatimin e Taksës administrative për leje ndërtimi të Ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b dhe c të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më dt: 26.07.2013 aprovoi këtë :

V E N D I M

Për aprovimin e takses administrative për leje të ndërtimit për vitin 2013

Neni 1.

Më këtë vendim aprovohet taksa administrative për Lëshimin e lejes së ndërtimit në territorin e komunës së Drenasit për vitin 2013, e llogaritur në lartësi prej 3.16€/m²

Lartësia e Takses Administrative të lejes së ndërtimit është në pajtim me Ligjin për Ndërtimin Nr.04/L-110 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifatat për Rregullimin në infrastrukturë

Neni 2.

Pjesë përbërse e këtij vendimi është Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjopa komunale në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2013

Neni 3.

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe financa të Komunes së Drenasit.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, ndërsa aplikohet nga 01.08.2013

Më dt: 29.07.2013
Drenas



Kryesusi i Kuvendit

Naim Bazaj
Naim Bazaj